


UDHËZUES PËR TKI I

METAMORPHOSIS Nr. 7



RESURSE TË HAPURA ARSIMORE

QASJA E SHPEJTË DHE E THJESHTË TE PËRMBAJTJET ARSIMORE NË INTERNET NA MUNDËSON TË PËRPAROJMË MË SHPEJTË SI INDIVIDË DHE TË KONTRIBUOJMË BASHKËRISHT PËR AVANCIMIN E DIJES. DIJA E RE MUND TË PËRFITOHET ME PAK PARA, POR KA FUQI TË MJAFTESTHME TË NDËRTOJË NJË SHOQËRI TË PASUR.



“Udhëzuesi për TKI” numër 7 i fondacionit Metamrfozis është për të gjithë, për shkak se secili që dëshiron të mësojë dhe të përfitojë njohuri të reja mund të ketë dobi prej tij. Ky udhëzues u dedikohet edhe atyre që e krijojnë dijen dhe që dëshirojnë ta shpërndajnë atë në çdo formë, me qëllim që të jetë më e qasshme dhe më e përhapur. Në këto faqe mund të njiheni me konceptin e resurseve të hapura arsimore dhe me iniciativat e ngjashme, gjenden në Maqedoni, mund të lexoni shembuj dhe praktika të mira nga zbatimi i tyre në botë, si dhe rekomandime për zhvillimin e tyre në të ardhmen. Qëllimi është të mësojmë dhe dijen e fituar ta zbatojmë menjëherë.

Ky botim, sikurse edhe të gjithë udhëzuesit e tjerë që i ka botuar fondacioni "Metamorphosis", në formë elektronike gjenden në ueb-faqen e fondacionit: www.metamorphosis.org.mk.

Për versionet në formë të shtypur, shkruani në info@metamorphosis.org.mk.

PËRMBAJTJA:

TERMET KRYESORE	3
Ç'janë "resurset arsimore"?	3
Ç'janë "resurset e hapura arsimore"?	3
Një historik i shkurtër i RHA-ve	3
Kush i promovon dhe i avanson RHA-të?	4
Kujt i nevojiten "resurset e hapura arsimore"?	4
Cili është qëllimi i resurseve të hapura arsimore?	4
Si është gjendja në Maqedoni?	5
LIRIA DHE TË DREJTAT AUTORIALE	5
Ku është kufiri ndërmjet informatave të lira dhe përmbajtjeve të mbrojtura autoriale?	5
Resurset e hapura arsimore si pjesë e lëvizjes së hapur	6
"Creative commons" dhe resurset e hapura arsimore	8
Ku gjendet "Creative Commons" në botën e të drejtave autoriale?	8
Si funksionon "Creative Commons"?	8
Bashkëpunimi ndërmjet resurseve të hapura arsimore dhe qasjes së hapur	10
Cilat janë përparësitë nga zbatimi i qasjes së hapur?	11
Kodi i hapur, softueri i lirë dhe resurset e hapura arsimore	12
Dallimi ndërmjet softuerit me kod të hapur dhe softuerit të lirë	12
Ndikimi i softuerit me kod të hapur mbi arsimin	13
PËRVOJAT NGA ZBATIMI I RHA-ve	14
Përvoja të përgjithshme nga bota	14
METODA, UDHËZIME DHE SHEMBUJ	14
RHA-të në botë	14
RHA-të në Maqedoni	16
Udhëzime për zhvillimin e RHA-ve	16
Ku dëshirojmë të arrijmë me resurset e hapura arsimore?	17
Si ta përdorim ndonjë resurs të hapur arsimor në mësim?	17
Për projektin "iniciativa për resurse të hapura arsimore"	19
Linke të dobishme	20

1. TERMET KRYESORE

Ç'JANË “RESURSET ARSIMORE”?

Resurset arsimore janë mjete dhe materiale të ndryshme që përdoren në procesin arsimor dhe në procesin e nxënies së njohurive. Ato mund të përfshijnë libra mësimorë, fletore për ushtrime, doracakë, fjalorë të llojeve të ndryshme, literaturë profesionale, hulumtime, katalogje, por edhe programe kompjuterike, shërbime dhe platforma të internetit, softuerë të llojeve të ndryshme, baza digjitale me përmbajtje dhe të dhëna, etj., gjegjësisht, gjithçka që mund të përdoret për mësim dhe hulumtim.

Ç'JANË “RESURSET E HAPURA ARSIMORE”?

Resurset e hapura arsimore (RHA), *Open Education Resources* në gjuhën angleze, janë mjete dhe përmbajtje arsimore të lira për përdorim. Ato janë vegla pa pagesë që mund të shfrytëzohen për qëllime edukative dhe hulumtuese pa asnjë kompensim. Përveç kësaj, RHA-të janë të lira për shpërndarje (distribui), në bazë të të drejtave të përkufizuar autoriale, që mundësojnë shpërndarje të lirë dhe shumëzim të resurseve dhe mjeteve në fjalë. Në kontekstin e kohës sonë dhe epokës së internetit, me RHA-të, më shpesh nënkuptohen veglat arsimore të cilave mund t'u qasemi lehtë në internet dhe që janë të lira për përdorim. Problemet që paraqiten më shpesh gjatë përdorimit të resurseve arsimore (RA), kryesisht kanë të bëjnë me kufizimin e përdorimit të tyre, gjegjësisht ato janë në dispozicion për shfrytëzim për një numër të kufizuar grupesh ose individësh. Gjithashtu, një numër i madh i materialeve për edukim nuk mund të shpërndahet në mënyrë të lirë për shkak të të drejtave autoriale të cilat nuk lejojnë shumëzim të lirë. Mu në këtë drejtim veprojnë RHA-të, të cilat mjetet arsimore i konsiderojnë si “e mirë publike dhe e përbashkët” dhe punojnë në drejtim të lehtësimit të qasjes deri te materialet dhe mjetet për edukim.

HISTORIK I SHKURTËR I RHA-ve

Vetë koncepti i RHA-ve ndërlidhet me termin e Dejvid Uajlit (David Wiley) për “përmbajtje të hapur”¹ (anglisht, *open content*), të promovuar në vitet e '80-ta dhe të '90-ta të shekullit XX. Kjo shprehje e re e zgjeron idenë e ekzistimit të lidhjes ndërmjet lëvizjes për softuerë të lirë² dhe lëvizjes që angazhohet për përmbajtjet e hapura dhe shfrytëzimin e tyre, veçanërisht në arsim. Uajli ka marë pjesë në mënyrë aktive në krijimin e licencës së hapur për përmbajtje (që e lehtëson qasjen tek materialet dhe përmbajtjet), të pranuar në shkallë të gjerë dhe të njohur si “Open Publication Licence”.

Themelimi i “Creative Commons” në vitin 2001, si mënyrë për përkufizimin e një platforme të tërë të drejtash autoriale, të cilat e mundësojnë dhe lehtësojnë përbashkimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve, si dhe inisiativa për “OpenCourseWare” (OCW) e Universitetit MIT nga SHBA, gjegjësisht qasja e lirë në internet deri tek materialet mësimore të fakultetit, e kanë orientuar dhe përforcuar lëvizjen për RHA. Në vitin 2005, modelin “OCW” e miratuan një numër i madh institucionesh, kurse, gjatë vitit 2008, u evidentuan mbi 180 anëtarë anëmbanë botës të përkushtuar ndaj RHA-ve, që deri atëherë numëronte mbi 4000 doracakë dhe kurse. Njëri nga projektet më të zhvilluara është “The Connexions” i Universitetit të Teksasit, i cili paraqet një “bibliotekë onlajn” me një numër të madh materiale arsimore.

Vetë termi RHA, për herë të parë ka hyrë në përdorim në vitin 2002, në konferencën e UNESCO-s³, ku RHA-të janë konceptuar si “qasje të hapura deri tek resurset arsimore, të mundësuar nga teknologjitë e informatikës dhe të komunikimit, për konsultim, përdorim dhe adaptim nga një komunitet i shfrytëzuesve, për qëllime jokomerciale. Parë nga këndi praktik, sot RHA-të nënkuptojnë “materiale

1 Wiley, D. (1998), “OpenContent”.

2 „Open source software movement” (anglisht).

3 UNESCO's 2002 „Forum on the Impact of Open Courseware for Higher Education in Developing Countries”.

të digjitalizuara të cilat ofrohen për t'u përdorur në mënyrë të lirë nga ana e kuadrit arsimor, studentëve dhe individëve apo grupeve autodidakte, për mësimdhënie, mësim dhe hulumtim⁴". Me ndihmën e rrjetit të saj të përhapur, të zyrave dhe të projekteve, UNESCO-ja i është përkushtuar zhvillimit të mëtutjeshëm të të ashtuquajturit komunitet i RHA-ve.

KUSH I PROMOVON DHE I AVANCON RHA-të?

Edhe pse RHA-të kanë një histori akademike dhe hulumtuese, parimet e tyre më saktësisht janë përkufizuar nga OKB-ja dhe UNESCO-ja, të cilat kanë për qëllim t'i promovojnë gjerësisht vlerat dhe përfitimet që dalin prej tyre. Qëllimi është të lehtësohet qasja deri tek mjetet e edukimit, të tejkalohet dallimi ndërmjet vendeve të pasura e të varfëra dhe ndërmjet shtresave të ndryshme të atyre vendeve. E drejta për t'u arsimuar dhe për të pasur qasje tek mjetet për edukim është njëra nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, për të cilat duhet të kujdesen shoqëritë. Përveç Kombeve të Bashkuara dhe UNESCO-s, disa nga përkrahësit më të mëdhenj të aktiviteteve në favor të RHA-ve janë edhe "Organizata për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim" (OECD⁵), një numër i madh i universiteteve prestigjioze, ku bën pjesë dhe "MIT", që u përmend më lartë etj.

Disa nga përfitimet më të rëndësishme nga kjo qasje dhe nga puna që bazohet mbi parimet RHA-ve janë: enciklopedia e hapur "Wikipedia" (www.wikipedia.org), "Wikiedukatori" (<http://wikieducator.org>), "OER Commons" (<http://www.oercommons.org>), konzorciumi OCW (<http://ocwconsortium.org/>) dhe një sërë projektesh të tjera që janë realizuar nëpër dhjetëra vende anembanë botës, të cilët arsimin e bëjnë më të hapur dhe më të qasshëm për të gjithë ata që janë të interesuar të mësojnë dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre. Shikuar në përgjithësi, bëhet fjalë për një proces me metoda e mjete gjithnjë e më të shumta e me të reja, të cilat inkurajojnë dhe nxisin përbashkim dhe bashkëpunim në sferën e mësimin dhe të hulumtimit. Së këndejmi, pritet që lëvizja për RHA të zhvillohet intenzivisht dhe t'i realizojë gjithnjë e më shumë qëllimet e saj për "arsim të hapur".

Në Evropë, rolin kryesor në këtë proces e ka Bashkimi Evropian (BE-ja), nëpërmjet projektit të saj "OLCOS⁶" (Open eLearning Content Observatory Services), si pjesë e programit të BE-së për mësim elektronik (*eLearning*). Qëllimi i këtij projekti është

4 OECD, 2007: 31.

5 <http://www.oecd.org>

6 http://www.olcos.org/cms/upload/docs/olcos_roadmap.pdf

të "formohet një qendër me informacione onlajn që do t'i promovojë konceptet e RHA-ve, krijimin dhe përdorimin e tyre, e veçanërisht të *Përmbajtjeve të hapura arsimore digjitale*" (PHAD)⁷.

Në fund, vetë ideja e RHA-ve, varet më tepër nga vullneti dhe entuziazmi i vetë punëtorëve që janë të kyçur në procesin arsimor dhe atë shkencor. Energjia dhe vullneti i tyre për t'u lidhur, për ta lehtësuar fitimin e njohurive, për të gjetur mënyra se si t'i motivojnë dhe si t'i organizojnë ata që i edukojnë, për ta nxitur dëshirën për mësim dhe arsim tek të rinjtë, por edhe tek gjithë të tjerët që besojnë se mësimi është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës, janë faktorët më të rëndësishëm për RHA-të. RHA-të më tepër u takojnë vetë atyre që marrin pjesë në procesin arsimor dhe përkushtimit të tyre për arsim të hapur.

KUJT I NEVOJITEN "RESURSET E HAPURA ARSIMORE"?

Resurset e hapura arsimore kanë rëndësi universale, gjegjësisht janë të rëndësishme për të gjitha shoqëritë dhe vendet, pavarësisht shkallës së zhvillimit të tyre dhe lartësisë së standardit jetësor. Në të gjitha këto vende, RHA-të mund të kontribuojnë në masë të konsiderueshme për arsim më të hapur dhe më të lehtë. Megjithatë, për vendet e pazhvilluara, vendet që janë në zhvillim dhe shoqëritë në tranzicion, qasja e lirë deri tek mjetet arsimore ka rëndësi edhe më të madhe. Mund të thuhet se, për to, përdorimi i lirë i mjeteve arsimore ndikon shumë më tepër në mundësitë e zhvillimit dhe përparimit të shoqërisë.

CILI ËSHTË QËLLIMI I RESURSEVE TË HAPURA ARSIMORE?

Zhvillimi i shoqërisë dhe teknologjisë informatike kontribuoi në ndryshimin e mënyrës në të cilën zhvillohet procesi arsimor dhe hapi mundësi të reja për edukim. Njëkohësisht, mundësitë e reja paraqesin sfidë për mënyrat e përdorura deri më tani në zhvillimin e procesit arsimor, të cilat shndërrohen në një lloj pengese për ndryshime më të shpejta. RHA-të përpiqen t'i tejkalojnë këto pengesa që paraqiten në formë të të drejtave autoriale, qasjeve selektive, rregullave të ndërlikuara, pengesave të shfrytëzuesve etj.

Qëllimi kryesor i RHA-ve është të përmirësohet qasja tek dija dhe mundësitë për mësim. Kjo arrihet më lehtë duke e përbashkuar dijen dhe mjetet që e ndihmojnë mësimin dhe hulumtimin. Me këtë qasje, jo vetëm që mësimi bëhet më i lehtë dhe më

7 Open Digital Educational Content (ODEC).



i lirë, por kursehet edhe koha, mjetet materiale dhe resurset njerëzore që nevojiten për arritjen e qëllimeve arsimore.

Të qenit të hapur dhe inkluziviteti, që janë shumë të rëndësishme për RHA-të, e nxisin kreativitetin. Komunitetet që formohen komunikojnë më lehtë, këmbëjnë njohuri dhe informata, i kombinojnë më lehtë përvojat dhe vijnë deri tek zgjidhjet më të zbatueshme për mjediset përkatëse të cilave u dedikohen. Përveç promovimit të lirisë në arsim dhe në hulumtime, RHA-të kanë për qëllim të mundësojnë dhe zbatimin e të ashtuquajturit “arsim i hapur”, që nënkupton mundësimin e dijes për gjithë ata që kanë nevojë për të, përfshirë këtu dhe ata që hulumtojnë dhe kërkojnë dije.

Si ide, arsimi i hapur kërkon zhvillim gradual, që nënkupton disa nivele, në të cilat duhet të fokusohen shoqëritë:

- » përpilimin e teksteve mësimore dhe doracakëve të lirë për përdorim (që mund të shfrytëzohen pa pagesë),
- » organizimin dhe sistematizimin e mjeteve dhe materialeve arsimore që ato të mund të gjenden lehtë,
- » lehtësimin e parimeve për shumëzim të materialeve dhe rregullimin e të drejtave autoriale për këto përmbajtje,
- » krijimin e komuniteteve onlajn të edukatorëve, arsimtarëve, profesorëve, hulumtuesve, etj.

SI ËSHTË GJENDJA NË MAQEDONI?

Përveç teknologjizimit të shkollave dhe të institucioneve të tjera arsimore, në Republikën e Maqedonisë ka aktivitete dhe projekte të caktuara, të cilat kanë pika të përbashkëta me idetë dhe konceptet e RHA-ve. Një nga ato është edhe projekti për librat mësimorë pa pagesë, i cili realizohet që nga viti shkollor 2009/2010. Megjithatë, këto aktivitete hasin në një sërë problemesh, ndërkohë që vërehet dhe një koordinim i pamjaftueshëm i shtetit, sektorit joqeveritar, i organizatave dhe i fondacioneve ndërkombëtare, që këto aktivitete ta mundësojnë realizimin më të shpejtë të “arsimit të hapur”. Disa nga aktivitetet përputhen njëra me tjetrën, disa mungojnë, disa ndërpriten pa kaluar në fazën tjetër e kështu me radhë. Duhet të zhvillohet dhe të zbatohet një sistem i harmonizuar për teknologjizim, për futjen e softuerit, për miratimin e politikave zhvillimore, për realizimin e projekteve të domosdoshme dhe për krijimin e përmbajtjeve që do të përdoren për edukim, në përputhje me idetë e RHA-ve.

2. LIRIA DHE TË DREJTAT AUTORIALE

KU ËSHTË KUFIRI NDËRMJET INFORMATAVE TË LIRA DHE PËRMBAJTJEVE TË MBROJTURA AUTORIALE?

Interneti është një thesar i madh me informata dhe përmbajtje të çdo lloji. Sado e lehtë të jetë qasja në këto informata, pjesën më të madhe të tyre nuk mund ta shfrytëzoni lirisht, e kjo të jetë legale ose pa kufizime të caktuara. Shkaqet për këtë janë të drejtat ekzistuese autoriale, të cilat përcaktojnë në mënyrë të saktë se si mund të shfrytëzohen përmbajtjet në internet dhe cilat përmbajtje nuk mund të shumëzohen dhe të distribuohen. Pjesa më e madhe e fotografive, video-materialeve, shënimeve-audio, e kështu me radhë, janë të mbrojtura me të drejta autoriale, të cilat ua pamundësojnë që t'i ndryshoni ose t'i përshtatni në mënyrë legale për nevojat tuaja, t'ua shpërndani nxënësve e të ngjashme. Për këto përmbajtje duhet të merret leje ose duhet të paguhet ndonjë kompensim i caktuar. Problemet dhe situatat janë të ngjashme edhe me materialet në formë të shtypur.

Problemet që paraqiten dhe ndikojnë keq në zhvillimin e arsimit dhe të vënit në dispozicion të materialeve arsimore në tërësi, janë të shumta, mirëpo ekspertët i dallojnë dy më të rëndësishme:

- » përzierjen e përmbajtjeve komerciale dhe atyre arsimore
- » caktimin e dyfishtë apo të shumëfishtë të tatimit

Rasti i parë ka të bëjë me atë kur, për shumicën e përmbajtjeve arsimore zbatohen, pa përshtatje dhe lehtësime për ata të cilëve u dedikohen këto materiale, praktika dhe procedura që zbatohen për përmbajtjet komerciale, që shërbejnë për ofrimin e shërbimeve të ndryshme ose të zbavitjes.

Në rastin e dytë, bëhet fjalë për praktikën dhe përvojat në të cilat shtetet, institucionet, organizatat dhe subjektet e tjera, prodhojnë përmbajtje edukative dhe shkencore nga tatimet e qytetarëve, e pastaj, po ato përmbajtje i plasojnë si prodhime të pastra komerciale, për të cilat, shfrytëzuesi i fundit duhet të paguajë përsëri.

RHA-të kanë për qëllim që të përcaktohen në mënyrë precize ato përmbajtje dhe materiale që janë me interes arsimor publik, të ndahen nga përmbajtjet pastër komerciale dhe të lehtësohet qasja tek ato, duke u mbrojtur njëkohësisht dhe të

drejtat e autorëve nga keqpërdorimet e ndryshme. Pastaj, përmbajtjet që janë vlerësuar se janë me interes publik për arsimin dhe që më parë janë tatimuar, duhet të bëhen plotësisht të lira për përdorim dhe distribuim të mëtutjeshëm.

RESURSET E HAPURA ARSIMORE SI PJESE E LËVIZJES SË HAPUR

Gjatë shekullit XX u paraqitën shumë filozofi dhe modele “të hapura”, të cilat e kanë të përbashkët dëshirën për përbashkim të lirë, pengimin e krijimit të duplikateve, shmangien e të drejtave restriktive autoriale, promovimin e efikasitetit ekonomik dhe rritjen e qasjes tek palët e interesuara. Ja disa prej tyre që janë të rëndësishme për komunitetin arsimor:

Kodi i hapur (në biznes dhe në teknologji)	Filozofi që angazhohet për përshkrimin e praktikave që janë zbatuar në procesin zhvillues dhe që promovon rishpërndarjen dhe qasjen tek kodi burimor i produktit final.
Softueri me kod të hapur	Nënkupton të qenit në dispozicion të kodit të zhvilluar nga programuesit dhe lirinë e përshtatjes dhe ndryshimin e tij nga të tjerët
Hardueri me kod të hapur	Pajijse të përgatitura me dorë në aspektin teknologjik, të cilat janë dizajnuar dhe janë vënë në dispozicion, ngjashëm si softueri i lirë me kod të hapur
Standardet e hapura	Sipas përkufizimit të BE-së, të qenit i hapur nënkupton se: <ul style="list-style-type: none"> » standardi është i pranuar dhe do të mirëmbahet nga ndonjë organizatë joprofitabile dhe zhvillimi i tij do të bazohet në procedurë për marrje të lirë të vendimeve, që është në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara (vendosje me shumicë ose me koncensus) » standardi është publikuar dhe dokumenti me specifikat e tij është vënë në dispozicion pa pagesë ose për ndonjë shumë simbolike » për të, ka leje për kopjim, distribuim dhe përdorim pa harxhime ose për ndonjë shumë simbolike » pronësia intelektuale e standardit bazohet në lirimin e parevokueshëm nga pagesa për të drejtat autoriale, edhe pse lejohet mundësia për mbrojtje të patenteve » nuk ekzistojnë pengesa për ripërdorimin e standardit
Qasja e hapur	të qenit në dispozicion të përhershëm, pa pagesë, të literaturës hulumtuese në internetin publik, ku shfrytëzuesve u lejohet të lexojnë, të shkarkojnë, të kopjojnë, të distribuojnë, të shtypin, të kërkojnë ose të lidhen me tekstet e plota, lejohet që ato të indeksohen nga kërkuesit, të shtohen si të dhëna në ndonjë softuer ose të shfrytëzohen për çfarëdo lloji qëllimi të ligjshëm, pa pengesa financiare, ligjore dhe teknike, përveç pengesave që janë të lidhura në mënyrë të pandashme me vetë qasjen në internet
Dizajni i hapur	zhvillimi i produkteve fizike, i makinave dhe i sistemeve për shfrytëzimin e informatave të përbashkuara publikisht, për dizajn, më së shpeshti nëpërmjet internetit dhe pa kompenzim në të holla për dijen e shfrytëzuar
Dija e hapur	grup i parimeve ose metodologjive që janë të lidhura me bartjen e njohurive në mënyrë të hapur; dija përfshin të dhëna (shkencore, historike, gjeografike...), përmbajtje (muzikë, libra, film), informata të përgjithshme (për shembull: ato që dalin nga qeveria)



Të dhënat e hapura	ide prapa së cilës qëndron angazhimi për vënie në dispozicion të llojeve të caktuara të përmbajtjeve (më shpesh jotekstuale) dhe ripublikimi i lirë, pa asnjë lloj kufizimi për shkak të të drejtave autoriale, patenteve ose mekanizmave të tjerë për kontroll; me këtë term shpesh nënkuptohen të dhënat e hapura qeveritare
Përmbajtjet e hapura	bazohen në lejimin e katër “R”-ve: ripërdorimi i përmbajtjes në formë të pandryshuar, revizioni (adaptimi dhe ndryshimi), remiksi i përmbajtjes origjinale dhe asaj të ndryshuar, me ndonjë përmbajtje tjetër, me qëllim të krijimit të përmbajtjes së re dhe ridistribuimi (e drejta për t’i përbashkuar kopjet, origjinalet ose remikset me të tjerët)
Kurset e hapura softuerike	materiale për kurse të zhvilluara nga universitetet, të cilat përbashkohen lirshëm me botën nëpërmjet internetit
Resurset e hapura arsimore	mjete dhe përmbajtje arsimore të cilat janë të lira për përdorim; vegla arsimore pa pagesë, që mund të shfrytëzohen pa asnjë kompenzim për qëllime edukative dhe hulumtuese, të cilat promovojnë distribuim të lirë dhe e mundësojnë shumëzimin e tyre
Praktikat e hapura arsimore	praktika që e përkrahin krijimin, përdorimin dhe ripërdorimin e RHA-ve me kualitet të lartë nëpërmjet politikave të rregulluara, të cilat promovojnë modele pedagogjike, si dhe respektim dhe inkurajim të atyre të cilët mësojnë për t’u bërë bashkëkrijues në procesin e mësimin të tyre gjatë tërë jetës; kanë të bëjnë me komunitetin qeveritar që merret me RHA-të, krijuesit e politikave, menaxhuesit dhe administratorët nëpër organizata, profesionistët nga fusha e arsimit dhe njerëzit që mësojnë.



“CREATIVE COMMONS” DHE RESURSET E HAPURA ARSIMORE


Përvojat botërore tregojnë se me përmirësime dhe përshtatje të vazhdueshme ligjore, mund të pajtohen dhe të koordinohen këto dy pole, që në shikim të parë duken si të papajtueshme, gjegjësisht distribuimi i lirë dhe mbrojtja e të drejtave autoriale. Si shembull për një nga formulat më të suksesshme është sistemi i licencave që është rregulluar nga ana e “Creative Commons” (www.creativecommons.org), i cili zbatohet edhe në Maqedoni (<http://cc.org.mk/>). “Creative Commons”, e nënkupton shfrytëzimin e lirë të të ashtuquajturave licenca “Creative Commons” nga ana e artistëve, autorëve dhe zhvilluesve, të cilët dëshirojnë që një pjesë të të drejtave autoriale t’i mbajnë për vete, ndërsa një pjesë t’ia lënë publikut, duke e stimuluar në këtë mënyrë promovimin dhe shfrytëzimin më të madh të veprave që janë të mbrojtura pjesërisht. Nga ky këndvështrim, është e qartë lidhshmëria ndërmjet filozofisë në të cilën bazohen RHA-të dhe Creative Commons. Ato, jo vetëm që janë të afërta në aspekt konceptual, por edhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre.

Krijuesit e përmbajtjeve arsimore shfrytëzojnë shpesh licenca “Creative Commons” që t’i bëjnë ato të hapura për publikun. Mirëpo, Creative Commons është më tepër se kaq. Licencat që e karakterizojnë këtë brend janë të dedikuara për përbashkim të të gjitha llojeve të veprave kreative që mund të publikohen në internet, duke filluar nga proza, hulumtimet dhe muzika, e deri te blogje të tëra ose ueb-faqe që angazhohen për ripërdorim të lirë të të gjitha përmbajtjeve që janë publikuar në kuadër të tyre.

KU GJENDET “CREATIVE COMMONS” NË BOTËN E TË DREJTAVE AUTORIALE?

Licencat “Creative Commons” gjenden ndërmjet të drejtave autoriale të mbrojtura plotësisht dhe domenit publik, ku bëjnë pjesë veprat që mund

të shfrytëzohen pa asnjë kufizim ose kusht. Duke u gjendur diku në mes, këto licenca mundësojnë mbrojtje të veprave autoriale nga përdorimet e padëshiruara, ndërsa njëkohësisht e nxisin bashkëpunimin, përmirësimin e njohurive, kreativitetin dhe sasinë e përmbajtjeve që në përgjithësi janë në dispozicion në internet. Në këtë mënyrë kanë dobi edhe përbashkuesit, edhe ata për të cilët përbashkohen përmbajtjet.



SI FUNKSIONON “CREATIVE COMMONS”?

Në qoftë se jeni autor i ndonjë vepre dhe dëshironi ta publikoni atë nën licencën Creative Commons, duhet të shkoni në creativecommons.org/choose dhe ta plotësoni pyetësorin e shkurtër, në bazë të të cilit do t’u gjenerohet një kod, të cilin pastaj duhet ta futni në ueb-faqen, prezantimin, dokumentin tuaj... E gjithë procedura kryhet në internet dhe zgjat vetëm disa minuta.

Licenca e fituar u përgjigjet kushteve të cilat i keni pranuar ose i keni refuzuar gjatë plotësimit të pyetësorit, por që ta kuptoni plotësisht se çka u lejoni dhe çka u ndaloni të tjerëve, është mirë t’i dalloni 6 llojet e ndryshme të licencave Creative Commons:

- » Thekso burimin
- » Thekso burimin-Shpërndaj nën kushte të njëjta
- » Thekso burimin-Pa vepra të adaptuara



- » Thekso burimin-Jokomerciale
- » Thekso burimin-Jokomerciale- Shpërndaj nën kushte të njëjta
- » Thekso burimin-Jokomerciale-Pa vepra të adaptuara

Siç mund të shihet, kusht kryesor në çdo licencë është të theksohet burimi deri te vepra origjinale gjatë ripërdorimit të saj nga dikush tjetër. Me këtë shprehet mirënjohje gjatë shfrytëzimit të veprave dhe përhapet puna pas së cilës qëndrojnë autorët e veprave origjinale.

Gjatë përcaktimit të kushteve, autori mund të kërkojë shpërndarje të detyrueshme të veprave të ripërdorura, nën kushte të njëjta ose të ngjashme me ato të cilat i ka shënuar. Thënë thjesht: “nëse vepra ime është me licencë Creative commons, edhe ju do të duhet ta përdorni licencën e njëjtë kur do ta publikoni veprën tuaj që e keni nxjerrë nga vepra ime”.

Kushti i tretë kufizon që veprat të shfrytëzohen vetëm ashtu siç janë, gjegjësisht ndalon që të bëhen çfarëdo lloj ndryshimesh. Autori mund ta ndalojë edhe përdorimin e veprave të tij për qëllime komerciale, e poashtu mund edhe t’i kombinojë të gjitha këto kushte që të vendosë nivel më të lartë të mbrojtjes.

Në të gjitha rastet, ata që do të hasin në ndonjë vepër të publikuar nën licencën Creative commons, kanë të drejtë ta kopjojnë atë, ta distribuojnë dhe ta tregojnë publikisht.

Licencat Creative commons janë dokumente juridike, të cilat i nënshtrohen ligjit për të drejtat autoriale. Nëse dikush i shkel rregullat e parapara në licencën e ndonjë autori, për të mund të zbatohen masat përkatëse, siç është paraparë me ligj.

Shembull për implementimin e një licence të këtij

lloji mund të lexoni në ueb-faqen e-learning.mk, ndërsa në qoftë se dëshironi ta shpërndani ose ta gjeni ndonjë vepër, vizitoni cc.org.mk.

Në Maqedoni, është i lejuar me ligj vetëm shumëzimi i kufizuar i materialeve arsimore, ndërsa është i shpeshtë rasti kur materialet që janë financuar nga tatimet e qytetarëve, paguhen në mënyrë plotësuese nga shfrytëzuesit e fundit - nxënësit, studentët, hulumtuesit etj:

“Është i lejuar me ligj reprodukimi i librave mësimorë, i librave të leximit dhe i publikimeve të tjera të natyrës së ngjashme të veprave autoriale; reprodukimi i pjesërishëm ose i tërë i veprave të shkurtëra autoriale dhe veprave nga fusha e fotografisë, artit figurativ dhe artit të zbatuar, arkitekturës, dizajnit dhe kartografisë, ekskluzivisht vetëm për ilustrim në mësim dhe për qëllime jokomerciale”

Ligji për të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme, nënpjesa 1, neni 40.



BASHKËPUNIMI NDËRMJET RESURSEVE TË HAPURA ARSIMORE DHE QASJES SË HAPUR

Edhe resurset e hapura arsimore edhe qasja e hapur bazohen në parimin e të qenit të materialeve të hapura, gjegjësisht të qenit në dispozicion dhe përdorim të lirë të materialeve që janë të rëndësishme për veprimtarinë arsimore dhe atë hulumtuese. Më konkretisht, qasja e hapur angazhohet për prodhimin e materialeve hulumtuese me kualitet të lartë dhe shpërndarjen e tyre me qëllim të përparimit të veprimtarisë hulumtuese në tërësi.

Qasja e hapur del nga lidhja e traditës së vjetër me teknologjinë e re - internetin – dëshirës së shkencëtarëve që t'i publikojnë rezultatet e hulumtimeve të tyre në revistat shkencore, pa mos u paguar për këtë. Si rezultat i kësaj del një e mirë e përgjithshme, gjegjësisht distribuimi elektronik i revistave shkencore hulumtuese që është përhapur në tërë botën, si dhe qasja krejtësisht pa pagesë dhe e pakufizuar në to, nga ana e shkencëtarëve, studentëve, bursistëve, profesorëve dhe mendjeve të tjera kurioze.

Largimi i pengesave për t'iu qasur kësaj literature, ndikon në shpejtimin e procesit hulumtues, pasurimin e arsimit, shpërndarjen e asaj që është mësuar ndërmjet të pasurve dhe të varfërve.

Literatura për hulumtim me qasje të hapur përbëhet nga kopje të lira onlajn, të artikujve të recenzuar, nga dokumentet e konferencave dhe nga raportet teknike, tezat dhe dokumentet punuese. Ato mund të shfrytëzohen lirshëm për hulumtime, ligjerata dhe nevoja të tjera.

Me qasje të hapur në literaturë nënkuptohet të qenit e saj në dispozicion të përhershëm, pa pagesë në internetin publik, me leje që shfrytëzuesit të lexojnë, të shkarkojnë, të kopjojnë, të distribuojnë, të shtypin, të kërkojnë ose të vendosin linke deri të tekstet e plota të këtyre artikujve, ato të mund

indeksohen nga ana e kërkuesve në internet, të mund të shtohen si të dhëna në ndonjë softuer ose të përdoren për çfarëdo lloj qëllimi legal, pa pengesa financiare, ligjore ose teknike, përveç atyre që janë të lidhura me vetë qasjen në internet.

Fillimet e qasjes së hapur datojnë nga dhjetori i vitit 2011, me iniciativën për qasje të hapur të një grupi individësh, në kuadër të konferencës së Budapestit, të organizuar nga Instituti shoqëria e hapur.

Përmbajtjet me qasje të hapur ruhen në depo digjitale, të cilat paraqesin një lloj arkivi onlajn. Ato mundësojnë menaxhim, deponim dhe qasje në përmbajtjet digjitale. Depotë digjitale mund të kenë shumë forma, por më shpesh dallojmë dy lloje:

- » depo institucionale – të cilat paraqesin koleksione digjitale nga rezultatet e krijuara në kuadër të universiteteve ose institucioneve hulumtuese
- » depo të centralizuara – të cilat janë të bazuara në ndonjë fushë të caktuar

Edhe pse depotë mund të jenë të ndryshme, për shembull: disa universitete kanë resurse për mësim, gjegjësisht materiale arsimore, në të shumtën e rasteve ato janë të krijuara që të mundësojnë qasje të hapur deri te rezultatet e hulumtimeve në kuadër të institucionit.

Në qasjen e hapur dallojmë dy strategji, rrugën e artë dhe atë të gjelbër.

Rruga e artë ka të bëjë me publikimin e artikujve shkencorë në revista me qasje të hapur, por përfshin edhe kontribute origjinale si monografi, libra kolektivë etj.

Rruga e gjelbër deri te qasja e hapur ka të bëjë me vetë-arkivimin e dokumenteve digjitale në serverë të hapur institucionalë ose në serverë të bazuar në



tema të caktuara, edhe atë paralelisht, para ose pas publikimit në revista, të cilat kërkojnë pagesën e qasjes në to. Tekstet vetë-arkivuese më shpesh janë në version para ose pas shtypjes, mirëpo arkivat përbëhen edhe nga monografitë, raportet nga hulumtimet, materialet e konferencave etj.

CILAT JANË PËRPARËSITË NGA ZBATIMI I QASJES SË HAPUR?

- » Literatura me qasje të hapur është me kualitet të lartë dhe e përgatitur sipas standardeve.
- » Qasja e hapur është kompatible me botimet e shtypura. Ajo ka të bëjë me qasjen e lirë onlajn deri tek literatura e revistave shkencore-hulumtuese, pa e përjashtuar mundësinë që të paguhet qasja deri tek materialet e njëjta në formë të shtypur.
- » Plagjiati zbulohet më lehtë për veprat me qasje të hapur.
- » Në një numër të madh rastesh, autorët kanë mundësi t'i publikojnë veprat e tyre me qasje të hapur edhe përkundër faktit se botuesi i këtyre veprave i ka të drejtat autoriale për botimin në formë të shtypur.
- » Veprat me qasje të hapur mund të publikohen nën licencën Creative Commons.
- » Qasja e hapur është ekonomikisht e realizueshme. Ajo u jep lexuesve kurajo të madhe për të gjetur dhe shfrytëzuar literaturë relevante, ndërsa autorëve dhe veprave të tyre u ofron gjëra të matshme - dukshmëri, lexueshmëri dhe ndikim të ri e shumë të madh.
- » Qasja e hapur mundëson krahasimin e rezultateve, krijimin e të dhënave të reja dhe

dijes së re që është e bazuar në rezultatet e hulumtimeve të mëparshme.

- » Qasja e hapur e rrit përqindjen e citimit.
- » Qasja e hapur mundëson ruajtje afatgjate të veprave shkencore-hulumtuese dhe përparim të veprimtarisë shkencore.
- » Përmbajtjet me qasje të hapur mundësojnë kursim të kohës dhe të parave – shumë më shpejt dhe shumë më lirë mund të mbahet një revistë me qasje të hapur në internet, se sa të investohet në dizajnimin, përgatitjen për shtyp, shtypjen dhe dsitribuimin e revistave në version joelektronik.

“Me vendosjen e një numri gjithnjë e më të madh të veprave shkencore nëpër depo dhe me rritjen e numrit të shkencëtarëve që i shfrytëzojnë depotë, edhe koha ndërmjet vendosjes së artikullit dhe citimit të artikullit nga të tjerët, zvogëlohet në mënyrë dramatike nga viti në vit.” – *Tim Brodi*

Rritja e përmbajtjeve që janë në dispozicion me qasje të hapur do të thotë investim në dije të re, e cila paraqet bazë për përhapjen e resurseve të hapura arsimore. Në këtë mënyrë, këto dy filozofi për qasje të hapur tek dija, në mënyrë ta pandashme kontribuojnë për arsim më kualitativ dhe për veprimtari më të zhvilluar shkencore.

KODI I HAPUR, SOFTUERI I LIRË DHE RESURSET E HAPURA ARSIMORE

Softueri me kod të hapur (Open source software) nënkupton të qenit në dispozicion të kodit i cili është zhvilluar nga ana e programuesve, lirinë e përshtatjes dhe ndryshimit nga ana e programuesve të tjerë. Zhvilluesit e këtij lloji të softuerit besojnë se, duke u lejuar të gjithë atyre që dëshirojnë të bëjnë ndonjë ndryshim në kod, ua mundësojnë që, në afat më të gjatë kohor, aplikacioni të bëhet më i dobishëm dhe me shumë më pak gabime në punë.

Kodi burimor i hapur (Open source code) zakonisht paraqet përpjekje bashkëpunuese të programuesve ta përmirësojnë kodin dhe t'i përbashkojnë ndryshimet me komunitetin. Në fakt, *Iniciativa për kod të hapur* (Open Source Initiative) bazohet në idenë se kur programuesit mund ta lexojnë, rishpërndajnë dhe modifikojnë kodin burimor të një softueri, softueri evoluon. Softueri me kod të hapur në komunitetin me orientim teknik, u paraqit si reagim ndaj softuerit pronësor (komercial), të cilin e zhvillojnë kompanitë dhe i cili është i kontrolluar dhe në pronësi të tyre private.

Që një softuer të konsiderohet me kod të hapur duhet të plotësohen disa kritere:

- » Programi duhet të distribuohet pa pagesë, por mund të inkuadrohet si pjesë e ndonjë paketi së bashku me softuerin për të cilin duhet të paguhet një çmim i caktuar.
- » Kodi burimor duhet të vihet në dispozicion.
- » Çdokush mund ta ndryshojë kodin burimor.
- » Versionet e modifikuara mund të rishpërndahen.
- » Licenca e programit me kod të hapur nuk guxon të kërkojë përjashtim të ndonjë softueri tjetër ose pengim të punës së tij.
- » Licenca nuk guxon të jetë diskriminuese ndaj njerëzve të caktuar ose ndonjë grupi të caktuar njerëzish, e as ta kufizojë zbatimin e

softuerit në fusha të caktuara (për shembull në sektorin e biznesit).

Softueri me kod të hapur nuk distribuohet sipas marrëveshjes së njëjtë për licencim. Disa shfrytëzojnë licenca të lira softuerike, të ashtuquajtura *copyleft* ose GPL-kompatibile. Iniativa për kod të hapur momentalisht përkrah mbi 50 licenca.

Aplikacionet me kod të hapur i kanë edhe mungesat e tyre. Në fakt, për shkak se softueri i lirë e përkrah dhe e inkurajon modifikimin e kodit, për të nuk mund të jepet garancion dhe nuk mund të sigurohet përkrahje e sigurt teknike. Prandaj, disa kompani vendosin që produktet e tyre softuerike pa pagesë, t'i shesin në komplet me garancën dhe përkrahjen teknike. Për sektorin e biznesit kjo është shumë me rëndësi, për shkak se ofrimi i përkrahjes teknike është arsye që firmat të përcaktohen dhe të paguajnë për këtë lloj softueri, në vend që ta marrin nga interneti, pa harxhime plotësuese.

DALLIMI NDËRMJET SOFTUERIT ME KOD TË HAPUR DHE SOFTUERIT TË LIRË

Përkufizimet e këtyre dy termave janë shumë të ngjashme. Dallimi qëndron në theksimin e aspekteve të ndryshme. Përderisa në softuerin e lirë theksohet liria e cila u jepet shfrytëzuesve, termi kod i hapur shoqërohet me dukshmërinë e kodit burimor për të gjithë, duke e theksuar kualitetin e softuerit që është rezultat i modeleve zhvilluese që zbatohen në projektet për softuer të lirë me kod të hapur. Në disa raste, softueri i lirë nuk është krejtësisht me kod të hapur dhe e kundërta. Nga ana tjetër, softueri i lirë nuk është i njëjtë me softuerin pa pagesë (freeware).

Riçard Stallman, aktivisti për softuer të lirë, iniciatori i lëvizjes për softuer të lirë dhe krijuesi i projektit GNU, e sqaron dallimin ndërmjet qëllimeve të secilës lëvizje: "kodi i hapur është metodologji





zhvilluese, ndërsa softueri i lirë është lëvizje shoqërore”. Sidoqoftë, të dy termet kanë të bëjnë me softuer që vjen me të drejta dhe liri të caktuara për shfrytëzuesit. Të dy termet kanë të bëjnë me softuer të liruar nga licencat restriktive dhe mund të shfrytëzohet, kopjohet, studiohet, midifikohet dhe rishpërndahet pa kufizime.

Përderisa termi, softuer me kod të hapur është paksa i dykuptimshëm, duke e përzier faktin e të qenit në dispozicion me lirinë për shfrytëzim, modifikim dhe rishpërndarje, zhvilluesit e softuerit pajtohen për përdorimin e termit alternativ – softuer i lirë me kod të hapur, që e nënkupton softuerin me kod të hapur, i cili poashtu është i lirë.

NDIKIMI I SOFTUERIT ME KOD TË HAPUR MBI ARSIMIN

Resurset e hapura arsimore kanë shumë aspekte të përbashkëta me softuerin e lirë me kod të hapur, ndërsa këto terme për herë të parë janë ndërlidhur në vitin 1998, nga ana e Dejvid Uajlit, i cili ka bërë analogji ndërmjet konceptit të përmbajtjes së hapur dhe konceptit të kodit të hapur.

Resurset e hapura arsimore e ndihmojnë zhvillimin e softuerit të ri dhe më të mirë me kod të hapur. Duke i vënë në dispozicion përmbajtjet për edukim nga lëmia e programimit, softuerit të lirë, ndërtimit të komunitetit dhe kulturës së përbashkimit me licenca të lira, RHA-të u ndihmojnë nxënësve, studentëve, zhvilluesve të softuerit dhe të gjithë atyre që dëshirojnë të kyçen në procesin e zhvillimit, që duan të krijojnë zgjidhje të reja dhe më të mira softuerike, nga të cilët përfitojnë të gjithë shfrytëzuesit. Në këtë mënyrë, dija për softuer të lirë dhe të qenit e kësaj dije në dispozicion në formë të resurseve arsimore, e ndihmon zhvillimin dhe avansimin e këtij lloji të softuerit.

Nga ana tjetër, shumë shpesh mund të hasim në vegla dhe sisteme softuerike me kod të hapur,

të cilat mundësojnë menaxhim të përmbajtjeve arsimore dhe mësim të gjërave të reja nga lëmi të ndryshme, nëpërmjet llojeve të ndryshme të resurseve arsimore dhe duke shfrytëzuar metodologji të ndryshme.

Njëri nga projektet e para dhe më të njohura për resurse të hapura arsimore është Curriki (<http://www.curriki.org>). Pas krijimit të këtij ueb-projekti qëndron organizata joprofitabile me po të njëjtin emër, e cila është përgjegjëse për krijimin e një komuniteti global me arsimtarë, nxënës dhe prindër që krijojnë, shpërndajnë dhe gjejnë resurse për mësim që e përmirëson efikasitetin e arsimtarëve dhe rezultatet e nxënësve. Curriki nxit bashkëpunimin e përvojave të ndryshme që i kanë njerëzit nga mbarë bota në procesin e zhvillimit të resurseve më të mira për mësim (të kontrolluara dhe të testuara në klasë) dhe krijimin e kulturës së përparimit të vazhdueshëm.

Ekzistojnë shumë projekte të hapura edukative që janë realizuar me sukses, disa që kontribuojnë për avansimin e arsimit formal, disa të tjerë për avansimin e arsimit joformal, disa në formë të resurseve për mësim, e disa në formë të veglave që e ndihmojnë procesin e mësimin në ndonjë mënyrë tjetër. Sido që të vështrohen RHA-të, të qenit e tyre në dispozicion dhe mundësia për avansim dhe përbashkim, gjithmonë janë të mundura nëpërmjet internetit, ashtu siç funksionon edhe softueri me kod të hapur dhe çdo filozofi tjetër në kuadër të lëvizjes së hapur. Në të ardhmen, këto dy koncepte duhet të bashkëpunojnë edhe më tepër dhe t'i avansojnë rezultatet në të dyja sferat, si rezultat i mbindërtimit të vazhdueshëm të njohurive dhe i përmirësimit të mundësive softuerike për zhvillim të njohurive edhe më të mira në të ardhmen.

3. PËRVOJAT NGA ZBATIMI I RHA-ve

PËRVOJA TË PËRGJITHSHME NGA BOTA

Rësuret e hapura arsimore janë ide dhe procese të lidhura ngushtë me zhvillimin teknologjik. Edhe pse RHA-të zhvillojnë aktivitete jashtë sferës digjitale dhe internetit, siç janë mundësimi i qasjes së lirë deri te librat mësimorë dhe doracakët, megjithatë, përdorimi i kompjuterëve dhe i internetit në arsim, është njëra nga pikat kryesore ku ato fokusohen. Lidhja e lehtë dhe tejkalmi i kufizimeve gjeografike janë, me gjasë, përfitimi më i madh në procesin arsimor, për të cilin nevojiten kompjuterët dhe interneti. Në vendet ku zhvillimi teknologjik është i kufizuar, është shumë me rëndësi që kompjuterizimi i arsimit të bëhet paralelisht me trajnimin për atë se si të zbatohet interneti, përmbajtjet dhe programet digjitale në mënyrë sa më efikase në arsim.

Disa nga përvojat më të rëndësishme botërore nga zbatimi i RHA-ve, që duhet të veçohen për këtë doracak janë:

- » RHA-të mundësojnë qasje të lirë deri te dija, pa asnjë diskriminim në çfarëdo baze, nga ajo gjeografike deri te ajo sociale dhe ekonomike.
- » RHA-të mundësojnë kreativitet në procesin e mësimin dhe të risive.
- » Kreativiteti dhe risitë hapin lloje të reja komunikimi me nxënësit dhe studentët, me çrast i nxisin dhe i aktivizojnë ata gjatë procesit arsimor.
- » RHA-të i zvogëlojnë harxhimet e nxënësve, studentëve dhe organizatave të ndryshme.
- » Kontributi për RHA-të do të thotë edhe kontribut për thesarin botëror të njohurive të përbashkuara, me çrast promovohen edhe parimet e arsimit të hapur.
- » RHA-të e nxisin zhvillimin e softuerit të lirë dhe zbatimin e tij efikas në arsim.
- » RHA-të e ndihmojnë zhvillimin e shoqërive, e përforcojnë kuadrin profesional dhe kapitalin arsimor.

4. METODA, UDHËZIME DHE SHEMBUJ

RHA-të NË BOTË

Në suaza botërore, zbatimi i RHA-ve dhe lehtësimi i qasjes deri te materialet arsimore bëhet në mënyra të ndryshme, mirëpo si më efikase tregohen ato metoda të cilat i shfrytëzojnë në mënyrë të koordinuar përfitimet që i ofrojnë teknologjitë e reja dhe interneti, të kombinuara me lidhjen e individëve dhe grupeve të veçanta në rrjete onlajn. Kjo, gjithsesi e lehtëson bashkëpunimin dhe këmbimin


OPEN EDUCATIONAL RESOURCES

 **creative commons**
 open source

e përvojave, materialeve dhe ideve. Njëra nga metodat aktuale më efektive është edhe zhvillimi i softuerit pa pagesë, i cili mundëson zbatim në mësim dhe në fusha të ndryshme shkencore.

Në vazhdim janë dhënë disa nga projektet më të suksesshme dhe më të rëndësishme që janë realizuar në kuadër të RHA-ve:

- » “Instituti për teknologji i Masaçusetsit” (MIT) nga SHBA-të e ka përgatitur




“OpenCourseWare” (<http://ocw.mit.edu>), që paraqet një sistem të lidhur onlajn, nëpërmjet të të cilit, të gjitha materialet që janë të nevojshme për lëndët në këtë universitet janë vënë në dispozicion për shkarkim pa pagesë. Aty ka materiale, prezantime, leksione, shënime nga ligjeratat dhe një sërë materialesh të tjera që janë të nevojshme për zhvillimin e lëndëve dhe përgatitjen për dhënien e provimeve.




Kjo u mundëson studentëve që shumë më lehtë të arrijnë deri te materialet dhe ta shfrytëzojnë kohën dhe energjinë e tyre gjatë studimeve në mënyrë më efektive. Gjithashtu, kuadri arsimor e ka më lehtë që të komunikojë në mënyrë më dinamike dhe t'i përshtasë përmbajtjet, pa pasur problem që ato të arrijnë deri te studentët.

- » „Carnegie Mellon University’s Open Learning Initiative“ është një sistem onlajn ku janë vënë në dispozicion lëndë të ndryshme universitare me përmbajtje multimediale, gjegjësisht një bazë e pasur me të dhëna dhe përmbajtje të teksteve, materiale vizuale, video dhe audio përmbajtje që janë të lira për shfrytëzim dhe reprodukim, me qëllim të zhvillimit më të lehtë dhe më efikas të mësimin. Ato, jo vetëm që e lehtësojnë qasjen deri te materialet e nevojshme administrative, planet, lëndët, etj., por edhe e pasurojnë mësimin dhe edukimin. Për shembull, video përmbajtjen e cila shfrytëzohet në mësim, tani shfrytëzuesit mund ta shohin dhe ta analizojnë në çdo kohë kur të kenë nevojë për të. E njëjta vlen edhe për një sërë materialesh të tjera, që nuk janë të kufizuara për përdorim vetëm nëpër sallat e ligjeratave ose laboratoreve.
- » “Universiteti virtual afrikan” (www.avu.org) është një projekt i madh, që mundëson shkarkim të lirë të përmbajtjeve të shtypura

dhe atyre digjitale, prej librave mësimorë, doracakëve, materialeve për prezantim e kështu me radhë, që u mundëson si mësimdhënësve, ashtu edhe studentëve, zhvillim më të lehtë të mësimin, por edhe kombinim kreativ dhe përmirësim të tyre.



- » Enciklopedia e hapur onlajn “Wikipedia” (www.wikipedia.org), poashtu është projekt që është pjesë e ideve dhe e koncepteve të RHA-së. Wikipedia është formuar në vitin 2001, dhe për 11 vjet, shfrytëzuesit dhe entuziastët në të kanë krijuar pothuajse 4 milionë artikuj të fushave të ndryshme, me një vëllim prej rreth 26 milionë faqesh.



- » Arkivi në internet për hulumtues, ku materialet janë të lira për shkarkim dhe shumëzim: <http://www.archive.org/>
- » Një numër i madh i materialeve, studimeve, prezantimeve dhe përmbajtjeve të tjera që kanë të bëjnë me RHA-të, janë në dispozicion publik në arkivin e RHA-ve, “OER Research” (www.oer.issue lab.org).

- » Shfrytëzimi i blogeve tregohet si vegël shumë e dobishme në procesin arsimor. Është shumë i madh numri i shembujve që e vërtetojnë dobinë e blogeve, jo vetëm për përbashkim të përmbajtjeve, por edhe për lidhje aktive dhe komunikim plotësisht të hapur të arsimtarëve dhe nxënësve.

RHA-të NË MAQEDONI

Për Maqedoninë, RHA-të nuk janë diçka e huaj, ashtu si idetë për qasje të lirë (Open Access). Siç tregojnë analizat, shihet se ka nevojë për një koordinim më të mirë ndërmjet vetë aktiviteteve, intensifikim të disave prej tyre, si dhe përmirësim të disa fazave për zhvillim të RHA-ve që janë realizuar.

Nëpërmjet disa ilustrimeve mund të fitohet një pasqyrë më e qartë për praktikatat e gjertanishme për RHA-të në Maqedoni:



- » Ministria për shoqëri informatike gjatë muajit prill të vitit 2010 e promovoi projektin për libra elektronikë pa pagesë dhe ueb-faqen “e-ucebnici.mk”. Aty janë publikuar 58 libra mësimorë në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke, të cilat mund të shihen lirisht, e poashtu mund të bëhet edhe kërkim nëpër përmbajtjet e tyre. Sa i përket këtij projekti, MASH-i deklaroi se: “Librat mësimorë elektronikë nuk do t’i zëvendësojnë librat në formë të shtypur. Qëllimi është që librat mësimorë të ofrohen në format elektronik, por rëndësia e librave mësimorë të shtypur është shumë e madhe... kjo është vetëm një mundësi më tepër për një mënyrë më kualitative të mësimit”. Librat mësimorë mund edhe të shkarkohen në formatin “PDF”. Sipas MSHIA-së, “ky shërbim është në zhvillim e sipër dhe në të ardhmen duhet të shndërrohet në resurs kryesor për qasje deri

te një numër i madh i librave elektronikë prej një vendi qendror.”

- » Ueb-faqja “skool.mk⁸” e përgatitur nga MSHIA-ja dhe nga “Byroja për reforma në arsim” (në vazhdim të tekstit BRA), është pjesë e rrjetit të “skool.com”. Ueb-faqja ofron vegla dhe përmbajtje nga sfera e matematikës, fizikës, kimisë dhe biologjisë. Kjo faqe përmban materiale interaktive audio dhe video, që mund të zbatohen në mësim dhe të japin kontribut për afrim kreativ dhe përgjithësim të përmbajtjeve mësimore nga këto lëndë dhe lëmi. Përmbajtjet e ofruara i përfshijnë këto lëndë të arsimit fillor dhe atij të mesëm, në relacion përmbajtësor me programin mësimor në RM, sipas të cilit zhvillohet mësimi në këto lëndë. Në këtë faqe janë ofruar edhe shënime të qarta për shfrytëzuesit e lëmive të matematikës dhe të shkencave natyrore.

- » E-uciliste.com është një koleksion onlajn i kurseve arsimore nga disa lëmi: informatika, fizika, kimia, elektroteknika, sistemet digjitale, HTML, etj.
- » “Wikipedia” në gjuhën shqipe shënon rritje sa i përket numrit të artikujve dhe përmbajtjeve që janë në dispozicion të shfrytëzuesve.

UDHËZIME PËR ZHVILLIMIN E RHA-ve

Trendet botërore nga fusha e RHA-ve, kryesisht janë të orientuara nga pasurimi i arkivave onlajn, zhvillimi i mëtutjeshëm i softuerit të lirë për qëllime edukative, mjeteve të ndryshme, përmbajtjeve multimediale, fjalorëve, doracakëve e kështu me radhë.

Në Maqedoni, përveç intensifikimit të projekteve ekzistuese (libra mësimorë falas, përmbajtje në Wikipedia, materiale për prezantim dhe zhvillim të mësimit, etj.), nevojitet edhe pasurimi i të ashtuquajturave “arkiva arsimore digjitale” ose “arkiva arsimore-shkencore onlajn”, si dhe ueb-faqeve të ngjashme. Popullarizimi dhe përkrahja aktive për publikimin e përmbajtjeve me licenca “Creative Commons”, tani për tani, nuk është shfrytëzuar sa duhet.

Vëllimi i përmbajtjeve që janë në dispozicion për mësim dhe për hulumtim duhet të rritet, veçanërisht për nivelet më të larta të arsimit dhe të veprimtarisë shkencore. Aktivitetet duhet të fokusohen për akumulimin e përmbajtjeve, për distribuimin e të cilave nuk ka kufizime në aspekt të të drejtave autoriale, siç janë veprat me pronësi autoriale më të

8 <http://skool.mk/>

vjetër se 70 vjet, dokumentet me rëndësi të madhe kulturore dhe kombëtare etj.

KU DËSHIROJMË TË ARRIJMË ME RESURSET E HAPURA ARSIMORE?

Shoqëritë moderne dhe bota në të cilën jetojmë, tërë zhvillimin e saj e mbështesin në dije. Pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për teknologjinë e zhvilluar, medicinën, biologjinë, astronominë, e kështu me radhë, të gjitha arrijtjet e njeriut bazohen në dije. Dija në ekonomi, sociologji, psikologji dhe shkencat e tjera, ka ndikim të madh në kualitetin e jetës sonë.

Gjithashtu, me përvojat të cilat njerëzimi i fitoi gjatë shekullit XX, nga luftërat botërore, rënia e kolonializmit, ndarja në blloqe dhe lufta e ftohtë, si dhe nga numri i madh i konflikteve etnike dhe fetare, mësuam se ndarja i dëmton njëlloj, si vendet dhe rajonet e zhvilluara, ashtu edhe ato të pazhvilluara.

Kjo e imponon nevojën që bota të lidhet, të bashkohet rreth dijes, e cila e lehtëson zhvillimin, përparimin, bashkëpunimin dhe tolerancën e dallimeve.

Maqedonia është një vend me pasuri të llojllojshme natyrore dhe kulturore. Zhvillimi i saj domosdoshmërisht është i lidhur dhe i kushtëzuar

me përparimin e dijes, profesionalizimin dhe avansimin e qytetarëve të saj. Lehtësimi i qasjes tek dija dhe mjetet për edukim, janë pjesë esenciale e këtij procesi të projektuar dhe i nevojës për zhvillim.

Në fund, ajo që duhet ta kemi si qëllim dhe për të cilën duhet të punojmë intensivisht dhe në mënyrë të koordinuar është:

- » Çdokujt t'i ofrohet mundësia për t'u shkolluar dhe për t'u avansuar në lëmitë për të cilat është i interesuar dhe për të cilat ka afinitete.
- » Qasja në materialet arsimore duhet të jetë e lehtë, si për nxënësit, ashtu edhe për arsimtarët.
- » Dijen dhe librat t'i hapim për të gjithë ata që janë të interesuar për to. Dija nuk duhet lënë që të zë myshk, por duhet të jetë pranë çdokujt që ka nevojë për të.
- » Interneti i lidh shumë lehtë njerëzit për shoqëri dhe argëtim. Arsimi dhe dija duhet t'i shfrytëzojnë arrijtjet e reja edhe për qëllimet e veta. Lidhja e njerëzve me interese, njohuri, aktivitete dhe afinitete të ngjashme në arsim dhe në shkencë, është një mundësi e madhe për të gjithë.

SI NDIHMOJNË RHA-të?

- » Më lehtë vijmë deri tek dija dhe materialet që na nevojiten për arsim
- » Harxhojmë më pak mjete dhe kohë për të arritur deri tek materialet që na nevojiten për mësim dhe hulumtime
- » U ndihmon arsimtarëve që t'i krijojnë dhe t'i shpërndajnë përmbajtjet që nevojiten për mësim.
- » Hap mundësi të reja për nxënie të dijes, i vë materialet në dispozicion për qasje në çdo kohë, e pasuron formën e tyre, nxënësit dhe studentët lidhen lehtë ndërmjet vete, ashtu si dhe arsimtarët me nxënësit dhe studentët.
- » Këmbejnë më lehtë dije dhe ide me nxënësit, studentët, arsimtarët dhe hulumtuesit e tjerë.
- » Dijen dhe informatat i vëmë në dispozicion për shoqërinë tonë, promovohet kultura dhe gjuhët lokale, lidhemi me botën e cila vazhdimisht zhvillohet.

ME CILAT PROBLEME BALLAFOHEN RHA-të?

- » Materiale të shtrenjta arsimore
- » Materiale arsimore që nuk ofrojnë liri për ndryshime ose distribuim, pa leje paraprake
- » Qasje e kufizuar tek materialet arsimore, që lejohen vetëm për një numër të kufizuar njerëzish, të regjistruar ose të punësuar në ndonjë organizatë ose institucion
- » Nxënës dhe arsimtarë që janë lënë vetëm dhe që janë izoluar nga komuniteti të cilit i takojnë

SI TA PËRDORIM NDONJË RESURS TË HAPUR ARSIMOR NË MËSIM?

Një pjesë e madhe prej nesh mund të shfrytëzojë një sërë metodash me anë të internetit për qëllime arsimore. Gjatë zhvillimit të mësimi, mund të përdoret ose të tregohet ndonjë përmbajtje që është e lirë për përdorim. Për shembull, në mësim kjo mund të bëhet duke e paraqitur ndonjë vepër të vlefshme artistike.

Njëri nga problemet që paraqitet është se si pastaj nxënësit, gjatë kryerjes së detyrave të shtpëisë, përgatitjes së materialeve të ndryshme dhe gjatë të mësuarit, përsëri të mund t'i shfrytëzojnë dhe t'i shohin materialet që janë përdorur gjatë orës mësimore. Kjo e imponon nevojën për lidhjen e arsimtarëve dhe të nxënësve, gjë që lehtëson qasjen deri tet materialet dhe përmbajtjet e përdorura, por edhe këmbimin e informatave dhe qëndrimeve për to. Arsimi nuk duhet të kufizohet vetëm në klasë, përkundrazi, kur ai është i hapur, përmirësohet edhe kualiteti i tij.




Disa nga mënyrat nëpërmjet të cilave arsimtari ose nxënësit mund të lidhen ndërmjet vete, janë rrjetet sociale dhe grupet që mund të formohen aty (për shembull në Facebook).

Mënyra e dytë është krijimi i të ashtuquajturave "grupe të e-mail-it", gjegjësisht të gjitha porosinë dhe informatat të dërgohen ose të shpërndahen nëpërmjet postës elektronike deri te të gjithë anëtarët e këtyre grupeve. Lidhja e këtyre mund të bëhet, për shembull me grupe në "Yahoo!" dhe në "Google":




Disa prej problemeve praktike me lidhjen e këtyre janë se të gjithë nxënësit duhet të hapin llogari në këto shërbime për e-mail. Ata janë të kufizuar në një shkallë të caktuar në mundësitë për qasje dhe publikim.

Në praktikë, blogu është treguar si mënyra më e dobishme për lidhjen e nxënësve, arsimtarëve dhe të interesuarve të tjerë në komunitete që lehtë këmbëjnë porosi, duke filluar nga linket e deri tek komentet, ndërsa ata, poashtu mund të publikojnë edhe përmbajtje. Blogu është platformë e hapur në çdo kohë, si për publikim, ashtu edhe për shikim, shkarkim, përbashkim të informatave e të ngjashme:



Në blog mund të shtohet numër i madh shfrytëzuesish, të cilët mund të lajmërohen me emrin dhe me fjalëkalimin e tyre si shfrytëzues, që pastaj mund të fusin përmbajtje në mënyrë të pavarur. Këto janë të ashtuquajturat "bloge bashkëpunuese", gjegjësisht bloge që e promovojnë bashkëpunimin dhe kontributin e përbashkët për përmbajtjet e tij.



PËR PROJEKTIN "INICIATIVA PËR RESURSE TË HAPURA ARSIMORE"

Përbajtjet arsimore në Maqedoni që janë në dispozicion të lirë, janë në nivel shumë të ulët, më tepër për shkak se institucionet arsimore dhe shkencore nuk i shfrytëzojnë potencialet e tyre për digjitalizim të materialeve, të cilat ato edhe ashtu i krijojnë dhe i shfrytëzojnë gjatë punës së tyre. Përgjashtimet e rralla janë rezultat i entuziazmit të individëve, por materialet e tyre gjenden vështirë sepse nuk janë publikuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe janë "të shpërndara" nëpër bloge personale, ueb-faqe të ndryshme, forume etj. Nuk ekzistojnë as detyrime ligjore, as kulturë e shpërndarjes së RHA-ve, e poashtu edhe institucionet nuk posedojnë kapacitete për zhvillim të pavarur të kësaj veprimtarie.

Në rrethana të këtilla, aktivitetet e projektit janë orientuar për ngritjen e vetëdijes për përfitimet nga shpërndarja e resurseve arsimore, rritjen e bashkëpunimit me institucionet kompetente shtetërore që angazhohen për përparimin e arsimit në Maqedoni, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme të institucioneve që dëshirojnë ta zbatojnë këtë koncept në punën e tyre.

Për këtë qëllim, së pari u formua një grup koordinativ me disa anëtarë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, shtetërore dhe universitare, si dhe arsimtarë dhe profesorë të shkollave fillore dhe të mesme. Me ndihmën e tyre shqyrtohen potencialet për implementimin e konceptit të resurseve të hapura arsimore në institucione, por edhe më gjerë, në nivel të gjithë vendit.

Njoftimi me këtë koncept dhe ngritja e vetëdijes do të realizohet nëpërmjet një sërë materialesh dhe prezantimesh promotive dhe edukative, diskutimesh me palët e interesuara dhe me anë të ueb-faqes rha.mk, që ka për qëllim të jetë një vend qendror për informim për këtë problematikë, por edhe për gjetjen dhe shpërndarjen e resurseve.

Projekti do të përmbyllet me një konferencë ndërkombëtare, nga e cila duhet të dalin konstatime dhe rekomandime për vendosjen e RHA-ve si një koncept i rëndësishëm në procesin e arsimit dhe të zhvillimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese në të ardhmen.



LINKE TË DOBISHME:

-  Ueb-faqja e "OER commons", komuniteti i organizuar rreth bashkëpunimit për RHA-të dhe "Creative Commons":
<http://www.oercommons.org/>
-  Baza onlajn me vegla dhe resurse edukative:
<http://oedb.org/library/features/80-oer-tools>
-  Baza me video materiale edukative nga pothuajse të gjitha lëmitë shkencore:
<http://www.khanacademy.org/#browse>
-  Baza onlajn me materiale edukative:
<http://catalog.flatworldknowledge.com/>
-  Baza onlajn me programe dhe materiale të MIT (Massachusetts Institute of Technology):
<http://ocw.mit.edu/index.htm>
-  Baza me vepra letrare klasike:
<http://www.classicreader.com/>
-  "MERLOT", baza multimediale me materiale edukative:
<http://www.merlot.org/merlot/index.htm>
-  Projekti "Biblioteka e hapur":
<http://openlibrary.org/>
-  Arkivi onlajn i resurseve të hapura arsimore:
<http://www.archive.org/>
-  "Arkivi i Aleksandrisë" është bazë me materiale dhe publikime elektronike në sferën e arkeologjisë dhe disiplinat e ngjashme hulumtuese: <http://alexandriarchive.org/>
-  Arkivi onlajn me kurse arsimore:
<http://www.montereyinstitute.org/nroc/>
-  Ueb-faqja e njërit prej komuniteteve më të rëndësishme për softuerë edukativë:
<http://sakaiproject.org/>

Botues: Metamorfozis

METAMORPHOSIS
Foundation for Internet and Society

Për botuesin: Bardhyl Jashari


Autorë të tekstit: Irina Shumadieva, Sead Xhigall

Përktheu: Valon Abdiu

Lekturoi: Fatmir Sulejmani

Përpunimi grafik: Koma

Autorët dhe Fondacioni Metamorfozis i mbajnë të drejtat autoriale mbi tekstet që janë publikuar në këtë udhëzues.

 **creativecommons** Përmbajtjet publikohen në formë digjitale nën licencën Creative Commons: Thekso burimin-Jokomerciale-Pa vepra të adaptuara. 2.5. Maqedoni
<http://creativecommons.org/licenses/by-sa/2.5/mk>

Ky botim është përkrahur nga Fondacioni shoqëri e hapur – Maqedoni dhe programi i rrjetit të Institutit shoqëri e hapur, në kuadër të projektit Iniciativa për resurse të hapura arsimore (Open Education Resources Initiative).



Metamorfozis është fondacioni i pavarur, jopartiak dhe joprofitabil me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë. Misioni i fondacionit Metamorfozis është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës, nëpërmjet zbatimit inovativ dhe përhapjes së dijes. Vlerat tona kryesore janë të qenit të hapur, barabarësia dhe liria.

Adresa për kontakt:

rr. "Apostoll Gusllarot" nr. 40,
1000 Shkup, Maqedoni
telefoni: +389 2 3109 325
faksi: +389 2 3109 325

e-mail: info@metamorphosis.org.mk
ueb-faqja: www.metamorphosis.org.mk

CIP - Каталогизacija во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје
37.014.1:004.738.5(035)

SHUMADIEVA, Irina
Udhëzues për TKI për resurse të hapura arsimore. Nr. 7 / [autorë të tekstit Irina Shumadieva, Sead Xhigall ; përktheu Valon Abdiu]. - Skopje : Fondacija Metamorfozis, 2012. - 20 str. : ilustr. ; 30 cm

Превод на делото: Отворени образовни ресурси / Ирина Шумадиева, Сеад Џигал

ISBN 978-608-4564-34-8

1. Xhigall, Sead [автор]. - I. Šumadieva, Irina види Shumadieva, Irina
a) Отворени образовни ресурси - Прирачници
COBISS.MK-ID 91430666